



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.579/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues dhe Faton Ademi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Endrit Qestaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.579/2021 i paraqitur nga Endrit Qestaj me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Endrit Qestaj me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se ka aplikuar, për regjistrim si votuese jashtë Kosove, dhe se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia ka refuzuar aplikimin për tu përfshirë në listë si votuese jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur imazh të dokumentit identifikues-pasaportë e Republikës së Kosovës dhe aplikacionin si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ brenda afatit kohor është përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur apelin e parashtruar nga Endrit Qestaj, siç shihet edhe në ankesat paraprake të aplikuesve me mbiemër Qestaj me vendbanim në Zvicër, e njëjta e-mail adresë ka dërguar aplikacione për personat me mbiemrin Qestaj, që kanë vendbanim në shtetin Gjermanisë.

Si të tilla, dërgimi i aplikacioneve për regjistrim pavarësisht se është i njëjti mbiemër, e që janë dërguar nga e-mail adresa "isuf\_qestaj@outlook.com" nuk konsiderohet rreth i ngushtë familjarë, për shkak që të gjitha aplikacionet e dërguara tashmë nga ky e-mail, janë aplikacione për persona që kanë vendbanim në Zvicër dhe Gjermani, e në data bazën e aplikimit për regjistrim, rezulton se është edhe një mbiemër Qestaj, me vendbanim në Suedi, dhe se të gjitha këto aplikacione për regjistrim janë refuzuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit Endrit Qestaj, ka bërë aplikimin për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes email adresës "isuf\_qestaj@outlook.com" e cila është adresë personale e axhës së tij Isuf Qestaj, dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se axha i tij Isuf Qestaj ka pasur autorizim për të aplikuar në emër të apellesit.

Paneli, gjithashtu ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë përmes një email-i për disa persona me mbiemër të njëjtë, dhe që kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë familjar pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në rreth të ngushtë familjare andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës,, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

*3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:*

*a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,*

*b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkëngjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,*

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar prova shkresore lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie e tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë, se KQZ-ja me rastin e mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë vendit ka bërë ndonjë shkeljeve eventuale të procedurës.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Endrit Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar. Paneli vlerëson se vetëm mbiemri nuk është i mjaftueshëm për te konstatuar se aplikimet janë brenda rrethit të ngushtë familjar, ndërsa nga tërësia e shkresave nuk rezulton se ka një autorizim për aplikim nga personi tjetër përkundër se është me mbiemrin e njëjtë, rrethi i ngushtë familjar po ashtu nga adresa nuk rezulton se aplikuesi ka një vendbanim me parashtruesin e apelit e qe ne kuptim te rrethit te ngushte familjar nuk ka ndonjë prove qe ka mbështetur apelin për ta provuar faktin e ekzistimit te afërsisë se tyre familjare, rrjedhimisht nga te gjitha këto paneli nuk mund te vërtetoj faktin se aplikuesi është ne rrethin e ngushte familjare me parashtruesin e apelit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 579/2021 më datën 02.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
Adnan Konushevci



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.